

Për ndryshje
D.S.N. V. A



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZEMËRTORE E DOKUMENTARIT - ARKIVËS
1948
PROT.
25.07.2025

Nr. 4748 / 2 Prot.

Tiranë, më 24.7 2025

Lënda: Dërgohet urdhri për njohje dhe zbatim

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 23, Tiranë

QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE TË RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE

Adresa: Skelë, Rruga "Kosova", 9401, Vlorë

Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 364, datë 24.7.2025 "Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Elektrike", në program të përbashkët studimi Bachelor në "Inxhinieri Elektrike", në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë", me Universitetin Politeknik të Barit, Itali".

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4749/Prot.

Tiranë, më 24.7. 2025

URDHËR

NR. 364, DATË 24.7.2025

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË “INXHINIERI ELEKTRIKE”, NË PROGRAM TË PËRBASHKËT
STUDIMI BACHELOR NË “INXHINIERI ELEKTRIKE”, NË UNIVERSITETIN
“ISMAIL QEMALI”, VLORË, ME UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË BARIT,
ITALI**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35, 73 dhe 80, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe shkronjës “g”, të pikës 2, të urdhrin nr. 113, datë 26.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inxhinieri Elektrike”, në program të përbashkët studimi “Bachelor” në “Inxhinieri Elektrike”, në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë me Universitetin Politeknik të Barit, Itali, me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën shqipe, angleze dhe italiane, përkatësisht me kodet P63BA0713S, P63BA0713A dhe P63BA0713I me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e dyfishtë “Bachelor” në “Inxhinieri Elektrike”, në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë dhe në Fakultetin respektiv në Universitetin Politeknik të Barit, Itali, referuar nivelit 6, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e riorganizuar të përbashkët të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inxhinieri Elektrike”, në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, fillon sipas legjislacionit në fuqi.
3. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
 6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.
-

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ANA KAPAJ

